



**Prill 2016**

## Çfarë ka të Re në SHUKALB

### SHUKALB Organizon Workshop në Ndhmë të Shoqërive UK të Konkurojnë për Grante



Në vazhdim të Thirrjes për Aplikim për Grante Konkurruese të ofruara nga Programi i Ujit për Danubin, SHUKALB organizoi një workshop në ambjentet e Fakultetit të Inxhinierisë

së Ndërtimit për të ndihmuar shoqëritë ujësjellës kanalizime të interesuara për të përgatitur propozimet e tyre. Qëllimi i workshop-it ishte informimi rreth kësaj Thirrje për Propozime dhe orientimi në procesin e aplikimit për grant. [lexo më shumë](#)

### SHUKALB Nis me Sukses Programin e Ri të Trajnimit me Dy Kurset e Para



SHUKALB njofton me krenari se përfundoi me sukses dhënien e dy kurseve të para të trajnimit “Menaxhimi i Humbjeve të Ujit I” dhe “Cilësia e Ujit në Sistemin e

Shpërndarjes”. Kurset e Trajnimit janë zhvilluar me mbështetjen e USAID në kuadër të projektit “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri”. Kursi i trajnimit “Menaxhimi i Humbjeve të Ujit I” u organizua më 17 -18 mars 2016, në Hotel Mondial në Tiranë. [lexo më shumë](#)



## Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri...

## Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike!

**2-3-4 Nëntor 2016,  
Tiranë, Shqipëri**

**Eventet e  
Ardhshme**

**Dita Botërore e Ujit 2016**

## Njoftim për Shtyp nga SHUKALB – Dita Botërore e Ujit 2016 – Puna dhe Uji

Sot, njerëzit në të gjithë botën festojnë rëndësinë e ujit në jetën e tyre të përditshme, si një nevojë themelore humane. Përtej kësaj, uji është i rëndësishëm për ruajtjen e shëndetit publik dhe mjedisit, dhe uji i sigurtë është thelbësor për të garantuar zhvillimin ekonomik. Tema e këtij viti e Ditës Botërore të Ujit “Puna dhe Uji” sjell në vëmendje forcën punëtore dhe karrierën në sektorin e ujit. Investimi në infrastrukturën ujore dhe gjendjen e teknologjisë së artit nuk janë të mjaftueshëm për të garantuar furnizim me ujë dhe shërbime të kanalizimeve të duhura dhe të besueshme. [lexo më shumë](#)

## Festimi i Ditës Botërore të Ujit nga Shoqëritë UK Anëtare të SHUKALB



Festimi i Ditës Botërore të Ujit, tashmë është kthyer në një traditë për SHUKALB dhe shoqëritë UK anëtare të saj. Siç ka ndodhur gjatë viteve të fundit, SHUKALB ka përgatitur materiale promocionale dhe për rritjen e ndërgjegjësimit të cilat përmbajnë mesazhe të Ditës

Botërore të Ujit, dhe këto materiale janë vënë në dispozicion të shoqërive UK në të gjithë vendin. SHUKALB, sëbashku me Grupimin Profesionistët e Rinj të Ujit të Shipërisë, organizuan një aktivitet publik ndërgjegjësimi pranë Liqenit Artificial në Tiranë, ku shpërndanë fletëpalosje sensibilizuese që përmbanin mesazhe dhe këshilla të ndryshme se si të kursejmë ujin. [lexo më shumë](#)

## Projekti “Zhvillimi Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri”

### Mbledhje e Grupit të Punës



Në përputhje me përpjekjet e vazhdueshme për krijimin e Programi Certifikimi të Bazuar në Testim për Menaxherët Operacionalë në

- Manaxhimi i Aktiveve - Prill 2016

- Manaxhimi i Humbjeve të Ujit II - 3 Maj 2016

**Bashkohuni me Ne!**



**Na tregoni se cfarë mendoni!**



Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, Projekti dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës organizuan një mbledhje të planifikuar të Grupit Punës.[lexo më shumë](#)

---

## Reforma në Sektorin e Ujit

### Reforma Kombëtare në Sektorin Ujësjetës– Kanalizime - Takime Rajonale



Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës do të organizojë takime rajonale për të prezantuar dhe shpjeguar, në detaje, Vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave me titull “Për ri-organizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.[lexo më shumë](#)

---

## Të tjera

### Fondi Shqiptar i Zhvillimit Hap Aplikimet për Projekte



Programi i Ujësjetësve Rural III (RWSP III) është vijim i dy programeve të mëparshëm RWSP I dhe II, objektivi i përgjithshëm i të cilit është “Përmirësimi i kushteve të jetesës së banorëve në zonat rurale dhe mbështetja e zhvillimit ekonomik të këtyre zonave nëpërmjet përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm të këtyre zonave”. Ky program financohet nga Banka Gjermane për Zhvillim-KfW, Bashkimi Evropian me programin IPA dhe Qeveria Shqiptare. Agjencia e Zbatimit të këtij programi është Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).[lexo më shumë](#)

---

## Trajnime dhe Mundësi Arsimimi

**Edicioni i 19-të i Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren e Shërbimeve Publike | Torino, Itali | 05-16 shtator 2016**

## **Shkolla e Rregulloreve Lokale të Torinos** njofton se ka fhapur zyrtarisht aplikimet për Edicionin e 19-të të **Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren e Shërbimeve Publike**.

Shkolla Verore u drejtohet studentëve të vitit të fundit, studentëve të diplomuar dhe zyrtarëve të Administratës Publike (bashkive, prefektuarave, organeve rajonale) dhe agjencive rregullatore.

Pjesëmarrësit që do të përzgjidhen do të mund të përfitojnë nga tarifat shumë të ulëta të regjistrimit; regjistrim falas për vendet jo anëtare të OBEZH (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) siç është Shqipëria dhe shteteve të anëtarësuaras rishitaz në BE. Regjistrimi përfshin 2 javë **akomodim falas** në Torino.

Aplikimet janë të hapura. Afati: **5 qershor 2016**.

Për informacion të mëtejshëm dhe formën e aplikimit ndiqni linkun: [www.turinschool.eu/iss](http://www.turinschool.eu/iss)

---

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

**Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,**

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

**E-mail:** [info@shukalb.al](mailto:info@shukalb.al), **Web:** [www.shukalb.al](http://www.shukalb.al)